

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Apple surprizon me risitë, AI bën gabimin e frikshëm dhe Tesla rikthen makinën që “fluturon”! Top Albani a Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/apple-surprizon-me-risite-ai-ben-gabimin-e-frikshem-dhe-tesla-rikthen-makinen-qe-fluturon-2/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 18:32:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 18:28:56 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4303b6300b67bd6a7187f9760185279b616af376c0a821bd0fcf179622a3e1d2
TEKSTI	498b863f4ebcd3d4ba921a5dc2b800d6cbdcba6b71bb91ff6d89aebcd636d158
PAMJA	17b5423caa176496c6ff91cec9199cb49143dbbc28774a3559a7daf9c347703b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ab68234ca03d4c4c6fe9dc454cd7030c8e8e5dd41d90161869c9949e0cc97011
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/ab68234ca03d4c4c6fe9dc454cd7030c8e8e5dd41d90161869c9949e0cc97011

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Tech Top Tech - News

Apple surprizon me risitë, AI bën gabimin e frikshëm dhe Tesla rikthen makinën që “fluturon”!



Redaksia T

26 Shtator 2026



Në çdo episod të “**Top Tech**” me **Mateo Kadriun** zbulojmë të rejtat më të fundit nga bota e madhe e teknologjisë. Me informacione dhe gjithçka të detajuar rreth risive dhe mundësive që po na ofrohen çdo ditë sidomos nga Inteligjenca Artificiale me avancimin e projekteve nga më të ndryshme.

iPhone 18 Pro pas një jave përdorimi/ A ia vlen vërtet ta ndërtoni telefonin sipas Mateo Kadriut...



Para se ta dëgjoni këtë lajm, shikoni pak telefonin që keni në dorë. Nëse e keni blerë vitin e kaluar, qetësohuni... nuk ka ardhur ende momenti të shisni veshkën për një telefon më të ri. Apple në fillim të Shtatorit prezantoi iPhone 18 Pro dhe iPhone 18 Pro Max, si zakonisht, interneti u nda në dy grupe: ata që thanë: “Duhet ta kem!” dhe ata që thanë: “Po ky është i njëjti telefon thjesht me ngjyrë tjetër!”

Unë zgjodha të marr iPhone 18 Pro-në dhe e kam përdorur për rreth një javë, ndaj po ju jap përshtypjet personale, jo çfarë thotë reklama për të. Kamera është shumë e mirë, sidomos në errësirë, por nëse vini nga iPhone 17 Pro, mos prisni të zbuloni një galaktikë të re. Fotot janë pak më të mira në ngjyra dhe kamera main tani ka dhe variable aperture.

Ajo që më ka bërë më shumë përshtypje është bateria. Më në fund, një telefon që në orën pesë të pasdites nuk të lë me 5% bateri. Me thënë të drejtën, tani e mbyll ditën pa menduar fare për karikuesin dhe, besojeni ose jo, ky është një nga ato përmirësime që e ndjen realisht në përdorimin e përditshëm. E gjitha kjo falë chipit të ri A20 Pro, të ndërtuar me teknologjinë 2 nm. Edhe karikimi është dukshëm më i shpejtë.

Dynamic Island është më e vogël. Jo super i vogël, por mund ta dallosh në krahasim me 17 Pro. Edhe pjesa e pasme tani është me ngjyrë të njëtrajtshme me trupin e telefonit. Shumë elegante... derisa t'i vendosësh koverin dhe të harrosh fare çfarë ngjyre kishe blerë.

Sa për Siri AI... ende nuk është ai shoku që të zgjidh hallet. Thjesht është shpejtuar pak, po nuk vërej ndonjë ndryshim të madh nga Apple Intelligence.

Pra, a ia vlen? Sipas përvojës sime, nëse keni një iPhone 15 Pro, 16 Pro ose 17 Pro dhe bateria ende ju mban mirë, nuk mendoj se keni ndonjë arsye të fortë për ta ndërruar këtë vit. Por nëse vini nga një model më i vjetër, ndryshimi ndihet qartë.

Apple më në fund palos iPhone-in dhe vjen me “iPhone Duo”... por a ia vlen 1,999 dollarë?

“A ju ka ndodhur ndonjëherë të thoni: “Sikur telefoni im të palosej?” Jo? As mua. Por Apple vendosi ta bëjë realitet. Pas vitesh pritjeje prezantoi iPhone Duo, telefonin e parë që paloset. Dhe po... paloset bukur. Edhe buxheti juaj bashkë me të.

“Kur hapet, ka një ekran 7.6 inç dhe të jep ndjesinë e një iPad-i të vogël. Apple thotë se ka fshehur pothuajse krejt vijën e palosjes falë Nano-texture, ka vendosur procesorin A20 Pro dhe një bateri që premtan deri në 44 orë përdorim në ekranin e jashtëm. Në fund të vitit do të mbështesë edhe Apple Pencil-in.

“Por tani vjen pjesa interesante. Për mendimin tim, nuk është se Apple bëri ndonjë revolucion. Madje hoqi Face ID dhe riktheu Touch ID. Është pak si të blesh një supermakinë dhe ta ndezësh me çelës fizik.

“Edhe forma nuk më bindi. Kur është i mbyllur duket si pasaportë dhe për ta përdorur rehat me një dorë duhet të kesh dorën e një lojtari të NBA-së.

“Pastaj çmimi: 1,999 dollarë. Sinqerisht, më duket se paguan më shumë dhe merr më pak sesa me një iPhone 18 Pro. Në thelb paguan për ekranin e madh dhe faktin që paloset.

“Po, për dikë që bën shumë gjëra njëkohësisht, sheh filma, punon në dy aplikacione ose kalon orë të tëra në telefon, mund të jetë zgjedhje interesante.

“Për mua? Është shumë bukur që Apple më në fund hyri në botën e telefonëve që palosen, por me ato para do të zgjidhja një iPhone 18 Pro, një iPad... dhe do të më mbeteshin ende para në xhep.

Apple Watch tani “dëgjon” bisedat tuaja dhe i përmbledh për ju?! Risia që po ngre pikëpyetje...

“Sa herë keni thënë “E kisha në majë të gjuhës...”? Epo, Apple ka vendosur që ora juaj të ketë kujtesë më të mirë se ju. U prezantuan Apple Watch Series 12 dhe Ultra 4, dhe risia më e madhe nuk është dizajni, por inteligjenca artificiale që mban mend bisedat tuaja.

Funksioni i ri quhet Live Rewind. Me dy shtypje të crown, ora të shfaq 15 sekondat e fundit të bisedës në tekst. Praktike? Ndoshta. Pak e frikshme? Edhe më shumë. Është për atë momentin kur thua: “Çfarë tha?” dhe ora përgjigjet: “Mos u shqetëso, se po dëgjoja unë.”

Apple thotë se nuk regjistron audio, por krijon përmbledhje të bisedave dhe të ndihmon të kujtosh mbledhje, takime apo detaje të rëndësishme. Ka edhe funksione të reja për shëndetin, si matja e rrahjeve të zemrës çdo pesë sekonda, një tregues i gatishmërisë së trupit për ditën dhe një “moshë biologjike” bazuar te të dhënat e shëndetit.

Por sinqerisht... për mua ky është më shumë një përditësim i softuerit sesa një orë e re. Madje, Series 12 ka edhe bezela pak më të trashë se Series 11, gjë që nuk e prisja. Nuk është se e dallon dikush, por kur e krahason, bie në sy.

Për mendimin tim, Apple nuk bëri ndonjë hap gjigant këtë vit. Po, sensori që mat çdo pesë sekonda është një përmirësim i bukur dhe funksionet e reja të Health janë aq të shumta sa Whoop dhe Fitbit me siguri nuk po flenë rehat. Por nëse prisnit një revolucion, këtë vit do të duhet të kënaqeni me një evolucion. Apple duket se ka investuar më shumë te inteligjenca

artificiale sesa te vetë ora.

Një identifikim i gabuar nga AI ngriti në këmbë ushtrinë e SHBA-së, gati për sulm! Ja si ndodhi gjithçka...

“Imagjinoni pak këtë skenë: avionët luftarakë janë ngritur në ajër, urdhrat janë dhënë, tensioni është në maksimum... dhe në sekondat e fundit dikush zbulon se arsyeja e gjithë operacionit ishte një gabim i inteligjencës artificiale. Jo një spiun. Jo një satelit. Një chatbot.

Kjo ndodhi realisht në Shtetet e Bashkuara. Sipas raportimeve, ushtria ishte gati të godiste një anije kineze, sepse një sistem me inteligjencë artificiale kishte identifikuar gabimisht ngarkesën e saj si pjesë të një programi bërthamor. Fatmirësisht, gabimi u zbulua në momentin e fundit dhe operacioni u anulua.

E gjithë historia nisi kur një analist përdori një chatbot për të analizuar informacionet. AI gaboi. Pastaj i njëjti chatbot e ktheu gabimin në një raport që dukej aq profesional, sa kaloi nëpër disa nivele komandimi pa u vënë në dyshim.

Kjo është pak si t'i kërkesë shokut të klasës të të bëjë detyrat, ai t'i kopjojë gabim nga interneti... dhe papritur drejtori shpall pushim ditën për gjithë shkollën. Vetëm se këtu nuk bëhet fjalë për një notë të keqe, Po flasim për një gabim që mund të kishte përshkallëzuar tensionet mes dy prej fuqive më të mëdha në botë.

Ekspertët thonë se inteligjenca artificiale mbetet një mjet shumë i vlefshëm, por vetëm kur ka kontroll të fortë njerëzor. Sepse AI mund të jetë shumë e shpejtë, shumë bindëse... dhe ndonjëherë shumë gabim.

Pra, herën tjetër kur ChatGPT, Claude ose Gemini, t'ju thotë me vetëbesim diçka të çuditshme, mos e besoni menjëherë. Në rastin më të keq ju prish një detyrë. Në rastin më ekstrem... mund të prishë paqen botërore.

Pas 8 vitesh pritjeje, Tesla Roadster rikthehet me një premtim të çmendur: Makina që mund të fluturojë?!

“Tetë vite. Ka njerëz që në kaq kohë kanë mbaruar universitetin, janë martuar, kanë fëmijë... ndërsa stafi i rezervimeve të Tesla Roadster gjithë këtë kohë, vazhdon me premtimin: “Do dale muajin tjetër.” Epo, duket se ai muaj më në fund erdhi.


Tesla ka njoftuar se më 1 tetor do të prezantojë gjeneratën e dytë të Roadster. Po flasim për makinën që u prezantua për herë të parë në vitin 2017 dhe që është shtyrë aq shumë deri sa të prodhohej, sa disa filluan të besonin se ishte thjesht një legjendë urbane.

Por prit... kjo nuk është një makinë e zakonshme. Elon Musk ka premtuar se versioni më ekstrem do të ketë teknologji të zhvilluar bashkë me SpaceX, madje me raketa të vogla me gaz që, sipas tij, mund ta bëjnë makinën të “fluturojë” në një farë mënyre. Sepse normalisht, kur një makinë i bën 0 në 100 shumë shpejt, hapi tjetër logjik është... të mos ecë më në tokë.

Pyetja e madhe tani është: a do të jetë më e shpejtë se Rimac Nevera? Sepse Nevera aktualisht është një nga makinat elektrike më të frikshme në planet dhe nuk e dorëzon kurorën kaq lehtë.

Për momentin kemi vetëm premtime. As shpejtësia përfundimtare, as koha reale 0-100 nuk janë konfirmuar. Dhe duke njohur historinë e Roadster-it, shumë njerëz po festojnë në zemër, ndërsa mbajnë syrin nga kalendari.

Gjithsesi, pas tetë vitesh pritjeje, vetëm fakti që do e shohim me në fund, është lajm. Tani mbetet të zbulojmë nëse Tesla do të prezantojë makinën elektrike më të shpejtë në botë... apo thjesht vonesën më të shpejtë në histori.



LAJME TË NGJASHME



Pas 8 vitesh pritjeje, Tesla Roadster rikthehet me një premtim të çmendur: Makina që mund të fluturojë?!

1 MIN



Një identifikim i gabuar nga AI ngriti në këmbë ushtrinë e SHBA-së, gati për sulm! Ja si ndodhi gjithçka...

1 MIN



Apple Watch tani "dëgjon" bisedat tuaja dhe i përmbledh për ju?! Risia që po ngre pikëpyetje...

1 MIN



Apple më në fund palos iPhone-in dhe vjen me "iPhone Duo"... por a ia vlen 1,999 dollarë?

1 MIN



iPhone 18 Pro pas një jave përdorimi/ A ia vlen vërtet ta ndërtoni telefonin sipas Mateo Kadriut...

2.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Punë e pagëndrueshme dhe pension i hershëm, studimi zbulon lidhjen me plakjen e trurit!



Gjiganti italian i modës Gucci nxjerr në treg atlete "Made in China"!



Tanimë gjërat kanë ndryshuar/Shenjat e zodiakut që më në fund po fillojnë një kapitull të ri të jetës së tyre!



Nations League, sonte SHQIPERË vs. BJELLORUSI/Ekskluzivisht në DigitAlb!



Aksident në Fushë-Krujë/Përplasen 3 automjete, humb jetën një 19-vjeçar!



A kaloni shumë kohë ulur? Ja çfarë mund të ndodhë nëse ecni çdo gjysmë ore!



A ju ndodh të shihni të njëjtën
ëndërr vazhdimisht? Çfarë mund
të fshihet pas saj?

Cindy Crawford përjetoi vite të
vështira për djalin e saj?

Madonna tërheq vëmendjen me
fotografi provokuese, pozon me
reçipeta transparente?

“The Real Rooneys” përballet
me kritika? A është jeta e Wayne
dhe Coleen Rooney vërtet kaq
autentike?

EDITORI SUGJERON



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.